

RAPORT I NDIKIMIT TE MJEDISIT

“RIKUALIFIKIM URBAN I SHESHEVE TË PALLATEVE TË SHEMBURA NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE FUSHË KRUJË”.

DREJTUSI I FIRMES “ERALD-G”SH.P.K

Inxh.Gezim Islami

TIRANE 2023

PËRMBAJTJA

1	Hyrje	4
1.1	Kuadri institucional dhe ligjor ne lidhje me vlerësimet e ndikimit në mjedis	5
1.1.2	Kuadri Kombëtar Ligjor dhe Administrativ	6
2	Aspekte teknike të projektit	6
2.1	Gjendja ekzistuese.....	7
2.2	Përshkrimi i projektit të propozuar.....	7
3	Ambjenti ekzistues.....	8

3.1	Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore.....	8
3.2	Terreni dhe vendet me pamje te veçantë	9
3.3	Klima.....	9
3.4	Gjeologjia dhe dherat	12
3.5	Hidrologjia, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	13
3.6	Habitati dhe biodiversiteti	13
3.7	Cilësia e ajrit.....	13
3.8	Zhurma	14
3.9	Komuniteti lokal dhe aspektet social – ekonomike.....	14
4	Impaktet e rëndësishme mjedisore.....	15
4.1	Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore.....	15
4.2	Terreni dhe vendet me pamje të veçantë	16
4.3	Klima.....	16
4.4	Gjeologjia dhe dherat	16
4.5	Hidrologjia, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.....	16
4.6	Habitati dhe biodiversiteti	17
4.7	Cilësia e ajrit.....	17
4.8	Zhurmat	18
4.9	Komuniteti lokal dhe aspektet social – ekonomike.....	18
5	Masat e propozuara lehtësuese.....	19
5.1	Masat e përgjithshme	19
5.2	Masat e veçanta	20
5.2.1	Arkeologjia dhe Trashëgimia Kulturore	21
5.2.2	Terreni dhe vendet me pamje të veçantë.....	22
5.2.3	Gjeologjia dhe Dherat	22

5.2.4	Hidrologjia, Ujërat Sipërfaqësore dhe Nëntokësore	23
5.2.5	Habitati dhe Biodiversiteti	23
5.2.6	Cilësia e Ajrit	24
6	Monitorimi i mjedisit	24
7	Aneksë.....	25

1. HYRJE

Projektet e ndërtimit të rrugëve, rikonstruksionit dhe ndërtimit të rrugëve dytësore e rurale rezultojnë në krijimin e kushteve lehtësuese për një rajon të dhënë që ka paraqitur vështirësi dhe levizje të kufizuara të mjeteve dhe mallrave. Ato së paku përmirësojnë cilësinë e lëvizjes në rrugët egzistuese. Në një situatë të tillë sidoqë të kryhet ndërtimi ato do të kenë efekte ndikuese në gjendjen natyrore të rajonit. Kjo lidhet si me ndikimet e ndërtimit ashtu edhe me ato të karakterit operativ për shkak të trafikut. Duke vijuar me tej, ndërtimi dhe shfrytëzimi do të ketë ndikime direkte ose indirekte në aspektet social – kulturore dhe social – ekonomike të “status quo-s”.

Natyrë e pyetjeve të shumta dhe të ndryshme që lindin në këtë rast kërkojnë marrjen e tyre në konsideratë gjatë aktiviteteve të ndërtimit dhe të shfrytëzimit. Ajo që kërkohet në këtë rast është trajtimi në mënyrë individuale të segmenteve rrugore dhe ndërhyrjeve.

Objekti i kësaj hyrje – përmbledhje për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Rikonstruksionit të shesheve të pallateve të shembura në territorin e Nj.A. Fushë Krujë, të minimizojë streset në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit, si dhe

- të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që të përbëjë një mjet nëpërmjet të cilit të bëhet e mundur që projekti i rrugës dhe infrastruktura të implementuara në kuadrin e Projektit të Integruar të

Qeverise Shqiptare të jenë në përputhje me legjislacionin ekzistues, aktet nënligjore dhe zakonet në Shqipëri, si dhe me Politikat Operative të Bashkise Kruje mbi Vlerësimin Mjedisor.Zhvendosjen e Detyruar dhe Trashëgiminë Kulturore, si dhe të mos kenë efekte të zgjatura negative mbi popullsinë e vendit, mjedisin natyror apo objektet me vlera të veçanta kulturore.

Në këtë kuadër do të realizohet projekti i rrugës “Rikualifikim urban i sheshit të pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë”.

Përgatitja e këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bërë duke u bazuar ne Termat e Referencës të Projektit si dhe duke marre në konsideratë dhe Kuadrin e Masave për Mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale për Njesine Fushë Krujë.Konsulenti e ka përshtatur Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit si dhe ligjit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.

Dokumenti mundëson një përmbledhje të përgjithshme të dhënave në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Plani i Menaxhimit Ambjental (PMA), duke përfshirë kuadrin ligjor dhe politik si dhe standardet ambjentale të aplikueshme, informacionin kryesor ambjental, impaktet potenciale të kthyeshme për ambientet fizike, ekologjike dhe social – ekonomike në zonën e Projektit, masat lehtësuese, programet e konsultimit publik etj.

1.1. Legjislacioni në lidhje me vlerësimin e impakteve në mjedis

Në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kërkohej: “...*mirembajtje e një ambjenti tepër të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm*”. Kjo, por edhe opinioni i tere shoqërisë i shprehur nepermejt ligjeve të tjere, detyron marrjen e masave imediate për rehabilitimin e mjedisit të degraduar gjatë “epokës së industrializimit socialist” dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese/ndertuese që gjithashtu shkaktojnë dëmtime të mjedisit. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat europiane të mbrojtjes së tij ndonse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen mjedisore daton në vitin 1993 dhe shprehet se : “te gjitha veprimtarite e personave fizike dhe ligjore, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të jenë të vlersimeve mjedisore”.Me tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore përcakton se : “mbrojtja mjedisore është detyrim i” të gjithë shtetasve dhe individëve me veprimtari në Shqipëri”

Ne lidhje me vleresimin e ndikimit ne mjedis – VNM eshte aprovuar dhe funksionon Ligji Nr. 8990, date 03.01.2003 “mbi impaktet mjedisore” i cili percakton te gjitha procedurat per pergatitjen dhe paraqitjen per miratim te VNM ne Republiken e Shqiperise.

Ligji Nr.8990 ka per qellim per te siguruar mundesimin e :

a) Nje vleresimi te pergjithshem me nderthurje te impakteve ambjentale te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qellim qe te parandalojne dhe te menjanojne efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur.

b) Nje pjese te procesit te vleresimit administrues me pjesemarrjen e institucioneve lokale dhe qendrore, institucioneve publike dhe organizatave jo fitim pruresse per ambjentin, promovuesit te projektit, specialisteve te ambjentit dhe personave juridike te specializuar ne ceshtjet ambjentale.

Per kete projekt, neni 26 i ligjit nr. 8990 kerkon pjesemarrje publike ne procesin e Vleresimit te Impaktit Ambjental ne linje me kerkesat e legjislacionit te ri ambjental dhe direktivave perkatese te BE.

Rregulloret me te rendesishme dhe ligjet e aplikuara per VNM-n jane si me poshte:

– Ligji nr. 8934 “Per mbrojtjen e mjedisit”;

– Ligji Nr. 8990 “Per Studimet e Vleresimeve Mjedisore”;

– Laë Nr. 8093 “Per burimet e ujrave” nga viti 1996 e permiresuar nga Ligjet Nr. 8375, 8605, 8736;

– Ligji Nr. 8897 “Per mbrojtjen e ndotjes se ajrit”;

– Ligji Nr. 8561 “Per rivendosjen dhe shfrytezimin e perkohshem te prones per interes publik”;

– Ligji Nr.7623 “Per pyjet dhe mbrojtjen e tyre” nga viti 1992 e ndryshuar nga nenet 63 dhe 64 nga

- Ligji Nr. 7839 “Per shfrytezimin e pyjeve”; dhe

– Ligji Nr. 7866 “Per Referendumin” qe perfshin ceshtjet e vecanta mjedisore

2-ASPEKTE TEKNIKE TE PROJEKTIT

Projekti konsiston ne realizimin e rruges “Rikualifikim urban i shesheve të pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë” me nje infrastrukture bashkekohore. Pergatitjen e skemes finale per punimet e listuara ne fletet e dhena per zonen si linjat e furnizimit me uje,te kanalizimit, rrjetin rrugor dhe ndricimin rrugor ashtu sic kerkohet ne detyren e projektimit, perfundimi i llogaritjeve hidraulike, pergatitja e profilave terthore pergatitja e profilave gjatesore e detajeve. Vizatimet duhet te jene te qarta dhe koncize dhe te prezantohen ne nje menyre te tille qe te mund te kuptohen dhe interpretohen lehtesisht nga kontraktori.

2.1 Gjendja ekzistuese

Sheshet e pallateve të shembura si pasojë e dëmtimit nga termeti janë ne gjendje mjaft alarmante pasi nuk janë sistemuar pas prishjes dhe e mungesa e investimeve në to i ka degraduar.Rrjeti i ujesjellesit gjithashtu pusetat dhe pajisjet ose mungojnë ose paraqiten në një gjendje tepër të amortizuar duke vështirësuar menaxhimin e sistemit te furnizimit me ujë. Është e nevojshme vlerësimi i kapacitetit përcjellës të tubacioneve si pasojë e ndërtimeve te reja (edhe shumë katëshe) të ndërtuara kohët e fundit në këtë zonë, duke patur parasysh zhvillimin urbanistik te zonës.Rrjeti i kanalizimeve te ujërave të zeza ka raste te ndërtimeve mbi kolektorë dhe puseta, puseta te shëmbura dhe të papërdorshme, duke vështirësuar punën e rrjetit te kanalizimeve. Shpesh here jane verifikuar bllokime dhe shperthime te ujerave te zeza.Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të shiut mund të themi se është totalisht i amortizuar apo mungon fare. Ujërat e shiut në qoftë se nuk largohen nga ndonjë pusetë, rrjedhin përgjate rrugëve ekzistuese duke krijuar pellgje apo përmytur zona te caktuara.

2.2 Përshkrimi i projektit të propozuar

“Rikualifikim urban i shesheve të pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë”. Projekti parashikon ndertimin e rrugëve ne pjesen me te madhe sipas akseve ekzistuese në përputhje me parametrat e rekomanduara, por ka dhe hapje rruge te re.

Projekti parashikon ndertimin e rrugeve te reja dhe sistemimin e shesheve duke ruajtur gjurmen e rruges dhe shesheve ekzistuese, por dhe ndertimin e rrugeve te reja(hyrje-daljet) dhe krijimin e hapësirave te reja rekreative. Projekti parashikon sistemimin e shesheve dhe çdo shesh ka veçoritë dhe të dhënat teknike të cilat paraqiten në projekt. Është parashikuar të bëhet largimi i grumbujve të mbeturinave apo materialeve të tjera inerte.Projekti do të realizojë dhe rregullimin e drenazhimit të ujërave sipërfaqësorë, duke përfshirë dhe mbeturinat, duke pasur parasysh që këto të kenë efektet minimale në mjedisin përreth.

-Terreni dhe vendet me pamje të veçanta

Te gjitha te dhenat mbi popullsine e Fushë Krujës u dhane nga Njësia Administrative e qytetit dhe ne detyren e projektimit. Popullsia e qytetit te Fushë Krujës deri ne vitin 2000 nga te dhenat eish komunes eshte 15000 banore. Studiusit demografe japin te dhena te peraferta me ato te Komunes.

Nje pjese e popullsisë jeton ne banesa 2-4 kate dhe pjesa me e madhe jeton ne banesa private 1-2 kate. Popullsia e pritshme e qytetit deri ne vitin 2030 eshte 30000 banore.

Nje perqendrim i tille eshte verejtur veçanerisht pas vitit 1990 me lejimin e levizjes se lire te njerezve dhe shtimin e ndertimeve te shumta.

EKONOMIA

F-Kruja renditet ne qendrat me nje zhvillim te mire ekonomik, tregtare te vendit. Jo vetem qyteti i F-Krujes, por i gjithë rrethi ne teresi ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t'u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si industria e cimentos, e mobilerise, ekonomia bujqesore.

Rritja e ritmeve te zhvillimit ne vendin tone, dhe atij turistik ne veçanti, kerkojne investime te vazhdueshme si per permiresimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe te ndertimit te rrugeve te reja per t'iu pergjigjur trafikut gjithmone ne rritje.

Klima

Kushtet klimatike

Hidrologjia e krahines se Fushë Krujës, varet se pari nga klima, se dyti nga topografia dhe gjeologjia. Faktoret klimatike te nje rendesie paresore jane rreshjet dhe menyra e perhapjes se tyre, lageshtia, temperatura dhe era, te cilat ndikojne ne avullimin dhe transpirimin.

Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit regjistrohet nga termometra te vendosura ne kafaze te hapura, te njohura si kafaze Stevenson, reth 2.0 m mbi nivelin e tokes. Mbrojtja eshte e nevojshme per tu mbrojtur nga reshjet dhe rezet e djellit.

Shume vrojtme temperature behen duke perdorur termometrat maksimal dhe minimale. Keto regjistrojne temperaturat maksimale dhe minimale qe kur instrumenti eshte vrojtuar per here te fundit.

Ne nenzonen mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperatures shkon nga nje minimum reth agimit, ne nje maksimum nga ½ deri 3 ore mbasi djelli ka aritur ne zenith, mbas te ciles ka nje renje te vazhdueshme gjate nates deri ne agim.

Temperatura mesatare ditore eshte mesatarja e temperatures maksimale dhe minimale dhe normalisht eshte brenda kufirit te mesatares te vertete qe regjistrohet ne menyre te vazhdueshme

Temperatura eshte matur ne grade Celsius.

Reshjet

Burimi i te gjitha reshjeve qe bien eshte dhe ndikimi i detit. Reshjet jane kryesisht ne forme shiu, por mund te ndodhin edhe si bresher, bore me shi, bore, mjegull ose vese.

Ne Shqiperi te dhenat per reshjet jane marre dhe regjistruar nga Instituti Hidrometeorologjik nga 226 (aktualisht 106) stacione matese shiu te shperndara ne te gjithe Shqiperine. Disa stacione jane te paisura me matesa qe regjistrojne ne menyre te vazhdueshme.

Matesat standarte te shiut ne Shqiperi jane bere prej llamarine dhe konsistojne ne nje cilinder me diameter 22 cm.

Reshjet ne zonen e Fushe-Krujes perbehen kryesisht prej shiut por mund te jene gjithashtu edhe ne forma te tjera, si bresher, bore me shi, bore, mjegull ose vese.

Nga pikpamja e shperndarjes se reshjeve zona konsiderohet shume homogjene.

Periudha me sasine me te madhe te reshjeve eshte gjysma e ftohte e vitit, gjate kesaj periudhe sasia mesatare e reshjeve eshte reth 70% e reshjeve totale vjetore. Ndersa pjesa tjeter e reshjeve vjetore bie ne sezonin e veres

3.3.4 Debora

Ultesira perendimore per shkak te ndikimit zbutes te detit nuk ka kushte te pershtatshme per krijimin e shtreses se bores. Ajo krijohet ralle por edhe kur krijohet nuk qendron gjate. Periudha me e pershtatshme per krijimin e shtreses se bores eshte Janar – Shkurti.

Ngricat e vjeshtes fillojne zakonisht nga fillimi i Dhjetorit, ndersa ngricat e Pranveres zgjasin deri ne mes te Marsit

3.3.5 Era

Shpejtësia dhe drejtimi i erës në Shqipëri matet me anemometra dhe me fluger (pllake). Në seksionin Fushe Kruje shpejtësia dhe drejtimi i erës janë të ndryshueshme dhe varen nga kushtet fiziko-geografike të terrenit.

Shpejtësia maksimale e erës (m/s) për periudha të ndryshme perseritjeje (50,20,10,5 vjet) jepen në tabelën e mëposhtme.

Shpërndarja e rastisjes së drejtimit të erërave në bazë të të dhënave stinore tregon një ecuri vjetore të shprehur mirë. Gjatë vitit në Nikel mbizotëron drejtimi i jug-lindjes. Ky drejtim mbizotëron në mënyrë të dukshme ndaj drejtimeve të tjera, vecanërisht gjatë stinës së dimrit me një rastisje prej 25,7%. Këto janë erera që fryjnë nga brenda vendit. Gjatë verës vërehet krejt e kundërta, d.m.th. kemi mbizotërimin e drejtimit veri-perëndim me një rastisje prej 20,5%. E gjithë kjo shprehet me kontrastin e theksuar termik, gjatë verës midis tokës dhe detit, që shkakton levizjen e ajrit detar prej detit në drejtim të tokës me anë të rrymave veri-perëndimore ose perëndimore.

Në stinën e pranverës mbizotërojnë erërat veriperëndimore dhe juglindore, me rastisje përkatësisht, 16,6% kurse në vjeshtë ato juglindore, me një rastisje 18,8%. Në Fushe Kruje erërat kanë një karakter të theksuar stinor, d.m.th. gjatë gjysmës së ftohtë të vitit ato fryjnë nga thellësia e vendit, kurse gjysmën e ngrohtë të vitit ato fryjnë nga deti në thellësi të territorit.

Muajt më të ftohtë të vitit janë Janar dhe Shkurti. Në këto muaj temperatura mesatare mujore e ajrit arrin vlerat nga 1,2 °C deri 7,0 °C. Si muaj më të ngrohtë të vitit paraqiten korriku dhe gushti ku temperatura mesatare mujore arrin shifrat nga 20,0 °C deri 24,5

Reshjet mesatare vjetore nga 2405... në 954,8...mm, pjesa më e madhe në pjesën e dimrit dhe të vjeshtës..

3.4 Gjeologjia dhe dherat

Në dukuritë fiziko-geologjike që zhvillohen në zonën e Fushe Krujes janë; Tjetërsimi dhe shkeputja shkembore. Tjetërsimi është i zhvilluar në nivelet më të larta ose të bute të ndërtuar nga depozitimet argjilo-ranoro-alevrolitike dhe më pak është zhvilluar në depozitimet flishore. Trashësia e produkteve të tjetërsimit që mbulon formacionin bazë në zonën flishore arrin deri 2,50 – 3,0 m. Ajo përfaqësohet nga suargjila me përmbajtje çakelli. Ndërsa produktet

aluvialo-deluviale te zones mollasike kryesisht pliocenike arrin deri 2.0 m me gjithe zonen e carjeve

3.6 Habitati dhe biodiversiteti

Rruga që do të rikonstruohet kalon përmes shtëpive të banorëve duke kaluar në një mjedis me interes ekologjik dhe me vlera natyrore.

Asnjë nga speciet e rralla ose jo te rrezikshme te florës dhe faunës gjenden ne pjesët e planifikuara te rrugës. Megjithatë kjo zonë në tërësi ka një shumëllojshmëri bimësie.

3.7 Cilësia e ajrit

Shkarkimet e ndotjes se ajrit ne Shqipëri janë renduar qe ne fund te vitit 1980 dhe ne fillim te 1990. Gjate kësaj kohe ka pasur kontribute te ndryshme nga burime te ndryshme qe kane ndryshuar ne vazhdimësi. Shkarkimet nga prodhimet industriale kane rene për shkak te uljes se veprimtarisë industriale gjate 10-15 viteve te kaluara. Ne fillim te vitit 1990 kane rene edhe shkarkimet nga banesat por po te njëjtat arsye dhe si pasoje e ndryshimit nga gazrat fosile ne shfrytëzimin e elektricitetit. Kjo ka qellim qe te vazhdoje edhe gjate 1990. Gjate te njëjtës periudhe te shkarkimeve te trafikut janë rritur si pasoje e rritjes se menjëhershme ne zotërimin dhe shfrytëzimin e automjeteve.

Nuk ka asnjë rezultat te sakte ne lidhje me përshkrimin e cilësisë se ajrit ne Shqipëri për zonën e projektit, por mund të themi se cilësia e ajrit në këtë zonë është mjaft e mirë pasi trafiku rrugor është i pakët dhe mungojnë veprimtaritë industriale.

3.8 Zhurma

Organizata e Shendetit Boteror e perkufizon nivelin e zhurmes se “nje ndjenje pakenaqesie” qe sjell, ne kete rast, zhurma e makinave ne rruge. Aq me e madhe eshte zhurma dhe ndotja atmosferike nga makinat sa me e pa shtruar te jete rruga neper te cilen kalojne. Qendra e banuara, parqet, dhe siperfaqet e tjera rekreative mund te vuajne shume nga zhurmat. Nje nga impaktet me te rendesishme te shkaktuara nga trafiku eshte zhurma e ekspozuar per njerezit qe jetojne ne banesat afer aksit rrugor ne rikonstruksion. Ngaurvejimet e BE del qe nje numer shume i madh i popullsisë ndihet teper i merztur nga zhurmat e shkaktuara nga trafiku i rruges. Zhurma ngelet nje tingull teper i merzitshem dhe i padeshiruar qe percillet vecanerisht nga

individët. Niveli fizik i zhurmës nuk korrespondon direkt me nivelin e merzitetjes që ajo shkakton. Vlerësimi i impaktit të zhurmës përfshin konceptin e sasise e përgjigjeve personale të njerezve.

Zhurma e nderthurur me trafikun e rruges përgjithësisht konsiderohet që të jetë në një nivel më të lartë apo të ulët të zhurmave, megjithatë kjo nuk mund të jetë një prezantim tepër drejtë i zhurmave që rrjedhin nga trafiku aktual gjatë seksionit të rruges sipas projektit. Burimi më dominant i zhurmës së automjeteve janë zakonisht gomat dhe gazrat nga vjetërsia. Burimet e tjera më të rëndësishme të zhurmës janë motoret dhe tranzmisioni. Nivelet aktuale të zhurmës së segmentit rrugor do të jenë në varesi të kushteve të trafikut dhe përberjes së automjeteve. Aktualisht, banoret vërejnë se zhurma që vjen nga automjetet që kalojnë në rrugët pranë shesheve të pallateve të shembura qytetit Fushe Kruje është shqetësuese kur makinat e vjetra ecin me shpejtësi.

Njesia llogaritëse që bëhet matjen e zhurmës është decibel (dB). Ato shprehen në një shkallë net e cilen janë të perceptuara dyfish me nivelin e zhurmave që i korrespondon një rritje prej rreth 10 decibele. Asnjë matje për zhurmat në ambient nuk është bërë gjatë këtij studimi dhe asnjë matje e sakte nuk është e disponueshme për rrugën e propozuar. Meqë rruga kalon mes një rruge kryesisht rurale, zona është relativisht e qetë dhe niveli i zhurmave në ambient është relativisht i ulët.

3.9 Komuniteti lokal dhe aspekte sociale ekonomike

Këto sheshe ndodhen në qendër të qytetit Fushe Kruje. Shkalla e punësimit në zonë është pak a shumë ajo në shkallë vendi. Një pjesë e mirë e të rinjve të këtij qyteti kanë emigruar jashtë vendit; më shumë se 80% e tyre ndodhen në Itali dhe pjesa tjetër në Greqi. Ata janë të lidhur me familjet e tyre dhe pothuaj të gjithë gjatë sezonit të verës kthehen për pushime, gjë e cila shkakton një ngarkesë të madhe në rrugë për shkak të automjeteve të shumta që ata marrin me vete. Nga ana tjetër, është shumë i rëndësishëm fakti që ata veçse ndihmojnë familjet e tyre me të ardhura kanë filluar edhe të investojnë. Investimet në këtë zonë për shkak të pozitës gjeografike dhe pranisë së tregut, janë të shumta. Pjesa tjetër e popullsisë e cila ka vendosur të jetojë aty merren më shumë me aktivitete private, janë të punësuar në to apo janë pronarë.

3.10. Trafiku dhe siguria rrugore

Kërkesa e trafikut përcaktohet si nevojë zhvillimi, rritje shërbimesh si dhe sigurimin e një cilesie të jetë me komodë. Në Shqipëri, për shkak të prapambetjes së madhe në infrastrukturen rrugore,

megjithe perpjekjet e bera nga ekipe te ndryshme qeveritare, perseri kerkesa per rruge eshte e larte. Nga ana tjetere, rritja brutale e mjeteve motorrike ne perdorim vetiak dhe/ose familjar kerkojne rruge te shtruara dhe te gjera.

Eshte llogaritur se vetem si pasoje e sistemit te degraduar te rrugeve humbjet per qytetaret dhe bizneset jane shume te medha (harxhohet me shume se 30% e karburantit qe nevojitet per te njeten trajet dhe po aq kohe e humbur. Demi eshte i dyfishte: (i) humbje ekonomike me me shume se 30% e asaj qe nevojitet ne kushte normale dhe (ii) ndotja eshte rreth 35-40% me larte se ajo e shkaktuar ne kushte normale.

Siguria Rrugore: Aksidentet rrugore jane shkak i dyte i vdekjeve ne Shqiperi (pas atyre te semundjeve kardiovaskulare) dhe se situata vjen duke u perkeqesuar per shkak te rritjes se menjehershme te trafikut. Organizatat nderkombetare financuese po bejne investime te medha per sjelljen ne funksionim normal te rrjetit rrugor ne Shqiperi.

Shqiperia ka nivelin me te larte te aksideneteve fatale, vlerat jane shprehur zyrtarisht, ndermjet vendeve te tjera europiane. Çeshtja e sigurise rrugore dhe kerkeses per te patur nje mirembajtje sa me te pershtatshme rrugore mbetet teper themelore ne driten e statistikave zyrtare e cila tregon qarte se nivelet e trafikut ne infrastrukturen rrugore do te duhet te rriten edhe per nje periudhe 10 vjeçare me ritem 10% ne vit.

4. IMPAKTET E RËNDËSISHME MJEDISORE

4.1 Trashegimia Arkeologjike dhe Kulturore

Segmenti rrugor kalon neper trasene e nje rruge qe tashme eshte ne funksion dhe ne kete menyre nuk do te kete pasoja ne trashegimine kulturore apo arkeologjike te zones. Per kete arsye nuk nevojiten masa te veçanta te ruajtjes apo konservimit te tyre specifike.

Ndonse nuk ka te dhena per mbetje arkeologjike ne vendet qe do te gerrmohet gjate ndertimit te rruges, nese do te hasen te tilla gjate ndertimit, atehere punimet do te ndalohen menjehere ne ate perimter dhe do te pritet ekspertiza e specializuar per te vleresuar ecurine e metejshme te projektit. Punimet do te rinisin serish vetem pasi te jete leshuar konfirmimi nga autoritetet kompetente. E njejta procedure do te ndiqet edhe ne vendmarrjet e inerteve per ndertimin e segmentit ne rastet kur hasen objekte arkeologjike te rendesise se veçante.

4.2 Terreni dhe pamjet piktoreske

Do të jenë në qendër të vëmendjes. Në përgjithësi, me që aksi i rrugës është i hershëm, nuk pritet që të kemi modifikime të pamjeve pamore nga qendrat e banuara tashmë. Përmes dhe bankinat e mundshme (ngritje dhe ulje të terrenit për shkak të nivelimit të rrugës) tashmë janë konsoliduar dhe për më tepër nuk do të ketë çvendoseje masive dheu nga karexhata e rrugës dhe as mbushje të rëndësishme. Problemi mund të paraqitet në rastet kur kapicat e dheut ku do të merret materiali inert për mbushjen dhe shtrimin e rrugës do të vendosen në sheshet kryesore pranë vendbanimeve. Për këtë do të ketë konsultime dhe do të terhiqet opinioni i publikut për vend depozitimet e materialeve inerte. Do të synohet që të identifikohen pamje të fshehura të tyre me qëllim që të mos cenohet bukuria e peisazhit dhe as bimesia përgjatë aksit rrugor.

Një rëndësi për impaktin pamor do të ketë zgjerimet eventuale të karrexhates së rrugës përgjatë akseve të rrugës do të shkaktojnë demtimin në shkallë të vogël të bimesisë përgjatë rrugës. Çdo punim rrugor, edhe në rastin kur ajo ndërtohet në aksin ekzistues të një rruge të mëparshme, ka ndikim në mjedisin ku ajo kalon. Rruga me prezencën e vet dhe me ngjyren e zeze të shtresës së asfaltit është jashtë “ndertimit” natyror, përpos faktit që ajo krijon probleme konkrete të habitatit ekzistues.

4.3 KLIMA

Impakti i projektit në klimën e zonës përreth nuk është i rëndësishëm dhe për këtë arsye gjatë ndertimit dhe venien në funksionim të saj nuk do të ketë asnjë kërkesë për shërbime lehtësuese.

4.4 Gjeologjia dhe Dherat.

Sipas skemës së projektit nuk pritet të ketë asnjë impakt mbi gjeologjinë e rajonit dhe/ose zonës. Në trasenë ku rruga kalon do të ketë vetëm një gërmim të lehtë, jo më shumë se 25 cm dhe mbushje jo më shumë se 50 cm. Gjithë materiali që do të çvendoset do të ngarkohet në makina dhe do të depozitohet në një vend depozitimi që do të paracaktohet në bashkëpunim me organet komunale. Nuk priten të ketë gërmime/mbushje anësore përderisa rruga ekzistuese siguron gjerësinë e kërkuar në projekt.

4.5 Hidrologjia, Ujrat sipërfaqësore dhe Nentokesore

Ujrat nentokesore në aksin e rrugës janë afër sipërfaqes; ato ndodhen në thellësi 2-4 m dhe në këtë mënyrë ato janë të ndjeshme përkarshi çdo depozitimi ndotes. Nisur nga volumi i punimeve (gërmime dhe depozitime të vogla të dherave dhe sedimenteve) nuk parashikohet ndonjë impakt

direkt dhe i rëndësishëm i punimeve në këto ujra. Me potenciale në lidhje me ndotjen e ujrave nentokesore janë depozitimet/rrjedhjet e vajrave lubrifikante dhe/ose karburanteve të makinave të rënda gjatë punimeve ose, me pas, gjatë udhetimeve. Edhe në rast të derdhjeve të pavullnetshme (derdhje aksidentale) por edhe ndërrim i vajit ose rrjedhje të tij nga ana e makinerive të rënda mund të ndotin ujrat nentoksore.

Në rast derdhjesh të rëndësishme të karburanteve dhe/ose vajit lubrifikant, hidrokarburet, për shkak të gravitetit do të levizin drejt thellesisë duke u bashkuar me ujrat nentokesore. Po ashtu, në përzierje me ujrat sipërfaqesore ato do të levizin bashkë me ujin dhe kështu ndotja do të jetë më e madhe.

4.6 Habitati dhe biodiversiteti

Ndërtimi i rrugës së propozuar mund të çojë në humbje të përhershme të tokës që nevojitet për rrugën e projektit, e cila mund të çojë në shkatërrimin e habitateve, veçanërisht atje ku ekziston bimësi që duhet të hiqet. Zonat që mund të preken me shumë nga këto ndikime mund të jenë ato afër zonave të mbrojtura, pasi aty ka një diversitet të lartë natyror dhe është një zonë me vlera natyrore.

Gjatë ndërtimit do të ketë një numër ndikimesh të vogla direkte apo indirekte të tilla si pastrimi i bimësisë, gërryerjet e skarpave në gjurmime dhe mbushjet, prerja e drurëve të dobishëm etj.

Një pozicionim i pavëmendshëm i ndërtimit të kantierit të Kontraktorit dhe kampit të tij mund të sjellë shkatërrimin e habitateve natyrore dhe në migrimin e popullsisë së faunës larg nga kjo zonë për shkak të shqetësimit në zonë. Përveç kësaj një kontroll i pakët në lidhje me mbeturinat e lëngshme dhe të forta nga kantieri, së bashku me derdhjet apo shkarkimet e karburanteve dhe lubrifikanteve, mund të sjellë popullimin e dherave, degjenerimin e habitatit dhe dëmtimin apo shkatërrimin e foleve të zogjve shtegtare dhe llojeve të tjera të ngjashme.

Ndotja e ajrit, zhurmat dhe tronditjet e tokës për shkak të ndërtimit mund të sjellin në migrimin e popullatës së kafshëve për shkak të shqetësimit në zonë dhe zvogëlimit të efektit të shtegtimit të zogjve në afërsinë e rrugës. Një pluhur i tillë nga ndërtimi i rrugës mund të sjellë degjenerimin e habitatit dhe reduktimin e burimeve ushqyese për speciet e faunës. Gjatë fazës së ndërhyrjeve pasojat me dëmtuese mund të jetë vrasja e kafshëve që kalojnë rrugën.

4.7 Cilësia e ajrit

Faza e ndërtimit të një skeme rrugore mbetet burim shkarkimesh të substancave të caktuara që mund të kenë një impakt të përkohshëm në cilësinë e ajrit përreth kantierëve të ndërtimit. Gjate fazës së ndërtimit shkarkimi i pluhurave bashkohet me veprimtari të ndryshme siç është heqja e pemëve dhe dherave, gjurmimi i dherave dhe vendosja e po të njëjtit material në bankina dhe në strukturën e ndërtimit.

Shkarkimi i pluhurave varet në radhë të parë nga kushtet e kohës dhe në nivelin e veprimtarisë dhe llojin e ndërhyrjes që do kryhet. Gjithashtu pluhuri ngrihet nga rrotat e automjeteve të rënda të ndërtimit sepse ato kalojnë gjatë kantierit të ndërtimit gjatë periudhës së nxehtë.

4.8 Zhurmat

Gjate ndërtimit priten që zhurmat të shkaktohen nga makineritë e rënda të cilat do të transportojnë materialet/mbetjet që do të dalin nga gjurmimi dhe/ose ato që nevojiten për mbushje. Zhurmat do të jenë prezente gjatë fazës së ndërtimit dhe do të jenë shqetësuese për një distancë deri në 150 m.

4.9 Komuniteti Lokal dhe Aspekte Social Ekonomike

Impaktet janë si pozitive ashtu edhe negative:

Efektet më të rëndësishme pozitive janë:

- Rruga do të lehtësojë lëvizjen e automjeteve dhe rritjen e volumit të transportit.
- Do të lehtësojë dhe permiresojë lëvizjen.
- Kjo rrugë do të krijojë një lidhje më të mirë për rajonin
- Do të rrisë numrin e turistëve duke rritur kështu dhe të ardhurat.

Efektet negative konsistojnë:

- Gjate ndërtimit do të ketë pluhur dhe zhurmë (me shumë se zakonisht),
- Gjate fazës së ndërtimit mund të shkeputen tuba të frunizimit me ujë,
- Gjate ndërtimit kanalet e drenazhimit mund të bllokohen,
- Shpejtësia e automjeteve do të rritet dhe mundësia për aksidente është më e madhe, sidomos në qendrat e banuara.

5. MASAT E PROPOZUARA LEHTESUESE

Gjatë përgatitjes së VNM për nën-komponentë të ndryshëm duhet të merren në konsideratë të gjitha efektet pozitive dhe negative të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit, operimit dhe mbylljes/mirëmbajtjes mbas mbylljes, përfshi dhe aksidente të mundshme ekologjike. Për komponentët kryesorë të projektit, studimet e para – fizibilitetit kanë identifikuar një numër efektesh të mundshme. Këto përfshijnë rreziqe të lidhura me shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve të ndërtimit dhe publikut, zhurmën, pluhurin – që sjell efekte negative mbi cilësinë e ajrit; ndotje të dheut dhe ujit; rrjedhje sipërfaqësore, gjermimin e materialeve dhe hedhjen e dheut të tepërt; dhe rreziqet ndaj zonave të ndjeshme të mjedisit.

5.1 Masa te Pergjitheshme

Ne kontekstin e nje mase lehtesimi gjate ndertimit, kontraktori i rruges do detyrohet te pergatise nje plan ambjental qe siguron se:

- Punime ndertimi te realizohen kryesisht gjate dites,
- Kanalet ujtese dhe kulluese, kanalet anesore, rrjedhat e ujit te mbahen ne nje regjim minimum gjate punimeve maksimum ne rruge,
- Materialet e ndertimit do te merren ne vendin e prodhimit te inerteve,
- Mbeturinat e e gerrimit do te grumbullohen ne vende te posaçme te caktuara paraprakisht nga pushteti vendor dhe kontraktori,
- Aksi rrugor qe riparohet (gerrmin/mbushje) duhet te ujitet gjate periudhave te thata per te menjanuar shkarkimet e pluhurave, kjo e domosdoshme ne afersi te qendrave te banuara,
- Zonat me depozitime te perkohshme do te rehabilitohen per perdorimet te metejshme te tyre sipas destinacionit te meparsheme.
- Punime ndertimi të ndodhin kryesisht gjatë sezonit të thatë,
- Mbeturinat e forta dhe të lëngshme duhet të grumbullohen dhe/ ose riciklohen,
- Platforma rrugore ujitet gjatë periudhave të thata për të mënjanuar shkarkimet e pluhurave,
- Pemë tepër të vlefshme duhet të mbrohen.

5.2 Masa te veçanta

5.2.1 Zhurmat

Ndertuesi gjate fazes ndertuese, eshte i obliguar te zbatoje te gjitha masat kunder zhurmes, ne pershtatje me direktivat e BE (Rregullat e Niveleve te Pranueshme te Zhurmave, 1988). Masat qe duhen aplikuar konsistojne si me poshte:

1. Ne zonat e banuara:

- Punimet nderpriten gjate nates
- Punimet ne afersi te shkallave nderpriten gjate orarit mesimor (8:00 deri 13:00)
- Mjetet gerrmuese dhe ato transportuese do te perdorin detyrimisht silenciatore.
- Kompresoret duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese me kapaket e radhitur dhe te mbyllur mire te cilet do te mbahen mbyllur per sa kohe qe makinerite jane ne pune dhe te gjitha mjetet e tjera shtese pneumatike qe do te pershtaten me silenciatoret perkates,
- Makinerite qe do kene shfrytezim te here pas hershem do te mbyllet here pas here ne kohet kur nuk do te nevojitet per shfrytezim,

Persa i perket aktiviteteve te tjera jetesore dhe bizneseve:

- Ndertimet e reja per banim (shtepite) si dhe ndertesat per biznese duhet te behet ne baze te studimeve dhe planeve qe jane ne perputhje me rregulloren dhe mbrojtjen e natyres permes stimulimit te politikave te reja sipas legjislacionit ne fuqi,
- Harmonizimi sa me i mire i interesave dhe prioriteteve me njera tjetren per te rritur edhe me shume zhvillimin ekonomik, mireqenien dhe miqesore me mjedisin.

Gjate procesit te konsultimeve publike, nga ana e perpiluesve te ketij studimi mjedisor, rezulton se nuk ka asnje zhvendosje te 'komunitetit', dhe se asnje pronar nuk do ti "sakrifikohet" shtepia ose prona.

5.2.2 Konsultimi Publik

Konsultimet jane një pjese tepër e rëndësishme e procesit te VNM. Ne linje me zhvillimin e VNM është përgatitur një strategji për konsultimet. Konsultimet ne çështjet ambjentale janë bazuar ne 'Konventën e Aarhus', e cila përshtat një pikëpamje me baze te drejte dhe fokusohet

ne ndërveprimet mes autoriteteve te publikut dhe vete publikut ne një përmbajtje me demokratike.

Objektiva te veçanta te fushatës se informacionit publik dhe konsultimet publike janë përmbledhur si me poshtë:

- Për te ndare plotësisht informacionin rreth projektit te propozuar, përbërësit e tij dhe veprimtaritë me gjithë personat e prekur;
- Te arrije informacion rreth nevojave dhe prioriteteve te personave te prekur, si edhe rreth reagimeve te tyre për çështjet dhe veprimtaritë e propozuara;
- Te arrihet bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e njerëzve te prekur si dhe komuniteteve ne veprimtaritë e kërkuara qe duhet te ndërmerren
- Te siguroje transparence ne te gjitha veprimtaritë lidhur me zotërimin e tokës, rivendosjen dhe rehabilitimin.

5.2.3 Plani i menaxhimit ambjental

Plani i Menaxhimit Ambjental (PMA) përcakton mënyrat se si do te behet monitorimi i impakteve ambientale qe do te ndërmerren dhe zbatimin e masave lehtësuese qe do përfundohen ne fazën e ndërtimit. Drafti i PMA do te ketë nevojë te përpunohet me zhvillimin e projektit.

PMA është një dokument ne evoluim dhe do te ndryshoje vazhdimisht sa me shume te bëhen te ditura detajet e punimeve te rehabilitimit dhe ndërtimit dhe mendimet publike.

Drafti i PMA konsiston ne sa me poshtë:

- Një Plan i Lehtësimit Ambjentalist (PLA), qe nënvizon masat qe duhen marre për te lehtësuar ndikimet negative gjate fazave te ndryshme te Projektit;
- Një Plan Monitorimi Ambjentalist (PMoA), qe përcakton parametrat ambientaliste për t'u observuar dhe raportuar gjate fazave te ndryshme te Projektit;

Një Plan Menaxhimi Ambjental (PMA) po përgatitet si pjese e studimit te VNM-se me qellim qe te përcaktojë masat për ruajtjen e mjedisit dhe procedurat qe nevojiten për tu përshtatur me projektin si edhe për te njohur Pergjegjesite e tyre gjate zbatimit. PMA do te kompletohet kur procesi i projektimit do te ketë përfunduar dhe metodologjia e punës se Kontraktorit njihet dhe është përcaktuar përfundimisht. Kjo mund te rishikohet gjate zbatimit te projektit.

PMA është ndërtuar te përmbajë informacionet e mëposhtme:

- *masat lehtësuese;*

- *plani i monitorimit te ambientit;*
- *masat institucionale qe do te ndërmerren gjate ndërtimit dhe shfrytëzimit te projektit;*
- *veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit.*

Plani Monitorimit te Mjedisit do te përcaktojë mënyrat sipas te cilave do te kryhet monitorimi i ndikimeve ne ambient dhe zbatimi i masave lehtësuese gjate fazës se ndërtimit. Monitorimi do te përqendrohet ne numrin e kufizuar te ndikimeve te identifikuar gjate VNM-se për te siguruar efikasitetin e masave lehtësuese te planifikuara

5.2.4 Komuniteti Lokal dhe aspektet Social-Ekonomike

Gjate ndërtimit do te merren masa te veçanta nga ana e kontraktorit, me qëllim qe te behet mirëmbajtja e ujit, elektriciteti dhe shërbimet e tjera për qytetaret përreth.

ndërtimi i rrugës do te inkurajoje ne gjithë zhvillimin e zonës turistike përreth. Përmirësimi i rrugës se projektit do te inkurajoje turistet qe kane një rëndësi te madhe. Nga ana tjetër, aktivitete të tjera duhet te zhvillohen ne zonën përreth duke siguruar pjesën me te rëndësishme te infrastrukturës.

Te mëposhtmet janë rekomandime te përgjithshme, te cilat mund te ndihmojnë ne mirëmbajtjen e këtij investimi sa me shume të jetë e mundur si një instrument tepër i fuqishëm dhe i zhvilluar i mundshëm për:

- Biznesin vendas dhe te huaj qe duhet te drejtohet drejt sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë, si turizmi, nga ndihma e projekteve;
- Prodhimet më tradicionale përfituese që duhen stimuluar;
- Sektori i turizmit duhet të asistohet dhe të ndihmohet edhe më mirë (rreth e rrotull, urban, familjar, kulturor, historik etj.) duke e bërë komunitetin më të vetëdijshëm dhe duke përmirësuar infrastrukturën e turizmit.
- Interesat dhe prioritetet për tu harmonizuar sa më mirë me njëra tjetrën për të rritur edhe me shume zhvillimin ekonomik mirëqenien dhe pa asnjë impakt në ambient.

5.2.5 Terreni dhe vendet me pamje të veçantë

Një konsiderate e veçante i është dhënë mënjanimi te impakteve kudo qe shihet si e mundur gjate përzgjedhjes dhe projektimit te Skemës se Propozuar. Ne lidhje me këtë gjurma rrugore është përzgjedhur për te minimizuar impaktin ne zonat e banuara, detajet topografike, pemët dhe

ku është e mundur ne pyje. Për këto arsye u zgjodh që dhe rruga e propozuar të kalojë në gjurmët e rrugëve ekzistuese në mënyrë që impakti mjedisor të ishte sa më i vogël.

5.2.6 Gjeologjia dhe Dherat

Kapicat e dherave kudo që do zhvendosen duhet të menaxhohen saktësisht dhe të depozitohen para se të ripërdoren. Kjo duhet të jetë praktike që të përdoret menjëherë pas gërmimeve dhe nëse jo duhet të depozitohet në lartësira prej jo më shumë se 2 m.

Ne përfundimin e rrugës, do të ndërmerren inspektime vizuale në të gjitha strukturat gjatë gjurmës rrugore, që mund të ndërmerren për të siguruar që strukturat rrugore nuk shkaktojnë erozion, dhe që të identifikojnë kërkesat e duhura dhe ato që duhen për të ndërmarrë çdo punë të menjëhershme. Kjo mund të minimizojë impaktet e mundshme të ardhshme të humbjes së dherave dhe impakteve të lidhen me terrenin si shkak i erozionit.

5.2.7 Hidrologjia, Ujërat Sipërfaqësore dhe Nëntokësore

Gjate ndërtimit shkarkimi i mundshëm i materialeve ne ujë mund të konsiderohet një impakt negativ. Megjithatë raporti i VNM i kërkon palës së Kontraktorit që të zbatojë procedura të qëndrueshme gjate ndërtimit për të ulur rrezikun e ndotjes së rrjedhave të ujërave.

Gjate procesit të ndërtimit do të vendosen edhe masat për kontrollin e ndotjes. Këto do përfshijnë kushtin për gardhimet.

Derdhja e materialeve që shkarkohen nga kantieri i ndërtimit do të trajtohet në përputhje me llojin e tyre. Në rastin e një derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, do të përcaktohet nga ana e Kontraktorit një program për matjet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Testimi i ujërave nëntokësore duhet të bëjë matje në terren të pH, turbulencën dhe nxitjen elektrike.

Për periudhën kur rruga është në ndërtim e sipër, duhet të merren masa lehtësuese për kohe të gjate para se të nisë kontrolli i ndotjes dhe parandalimi i rrezikut.

5.2.8 Habitati dhe Biodiversiteti

Humbja e tokës dhe shkatërrimi i habitateve për shkak të ndërtimit të rrugës është i paevitueshëm. Megjithatë përzgjedhja e gjurmës së rrugës gjate fazës së projektimit është tepër e rëndësishme. Edhe pse kemi të bëjmë me një rikonstruksion të një gjurme rruge humbja e habitateve me vlerë do të konsiderohet si një problem dhe do të merren masa që në pjesët ku do të

jetë i nevojshëm largimi i bimësisë, pas përfundimit të punimeve të rehabilitohet zona duke mbjellë anash rrugës bimësi apo pemë.

Për te minimizuar impaktin nga ndërtimi i gjithë zhurmave dhe dridhjeve, kontrata do limitojë veprimtaritë e ndërtimit gjatë orëve të arsyeshme, normalisht ndërmjet orës 23 deri në 07 të mëngjesit. Mënyrat më të mira që duhen praktikuar duke përfshirë një impiant të mirëmbajtjes së përshtatshme, që do të punojë në minimizimin e zhurmës që vijnë nga punimet në kantier. Të gjitha automjetet dhe impiantet mekanike do të përshtaten me silenciatorë kundër zhurmave dhe do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune gjatë gjithë periudhës së kontratës. Kompresorë do të përshtaten me modele që duhet të vihen në mënyrë të përshtatshme dhe do të izoloohen me kapakë akustike të cilët do të mbahen të mbyllura kurdo që makineritë janë në përdorim e sipër dhe do të përshtaten me anë të mjeteve pneumatike ndihmëse me silenciatorët e përshtatshëm.

5.2.9 Cilësia e Ajrit

Nivelet e trafikut të projektuara për kohe afat gjatë janë tepër të ulëta dhe si të tilla ato shkaktojnë shkarkimet tepër të pakta.

Gjatë fazës së ndërtimit zbatimi i sistemeve për ngjeshjen e pluhurit siç është lagia me ujë e rrugëve e cila do të ndërmerret nga kontraktori për të limituar deri diku shkarkimet e pluhurit. Përveç kësaj makineria e ndërtimit do të nevojitet për të përmbushur të gjitha standardet e shkarkimit që udhëzon BE.

6. MONITORIMI MJEDISOR

Plani i Monitorimit Mjedisor përcakton menyrat se si do të bëhet monitorimi i impakteve mjedisore që do të ndërmerren dhe zbatimin e masave lehtësuese që do të përfundohen në fazën e ndërtimit.

Monitorimi do të përqendrohet në impaktet e identifikuar gjatë raportit të VNM për të siguruar ecueshmërinë e masave lehtësuese që janë planifikuar. Me poshtë, në formë tabelare paraqesim përmbledhjen e monitorimit, përgjegjësitë, menyrat dhe kohën e kryerjes.

Plani i Lehtësimit Ambientalist

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
<i>Mjedis Fisik</i>				
Dherat	<ul style="list-style-type: none"> Dëmtime të strukturës së dheut si pasojë e ruajtjes së materialeve, trafikut të transportit, etj. Humbja e dheut sipërfaqësor gjatë gërmimeve apo hedhjes së materialeve të ndërtimit Erozioni si pasojë e rrjedhjeve sipërfaqësore të pakontrolluara dhe shkarkimit të mbeturinave ujore 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për transport, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve Projektimi i drenazheve e strukturave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor 	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Toka	<ul style="list-style-type: none"> • Dëmtime të tokës gjatë ndërtimit. Rrëshqitje mbi skarpate, faqe kodrash, etj. • Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore • Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës • Projektimi i sipërfaqeve të pjerrëta dhe strukturave mbajtëse për të minimizuar rrezikun, sigurimi i drenazheve dhe stabilizimit të dheut/mbulimit të bimësisë • Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve • Transportimi/hedhja e materialeve nga/në vende të aprovuara 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
Burimet Ujore	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërprerja e drenazhimit sipërfaqësor dhe nëntokësor gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, krijimi i ujit të ndenjtur • Ndotja/infektimi i burimeve nga punimet ndërtimore, mbeturinat njerëzore apo të kafshëve përfshi karburantet & vajrat, mbetjet e rrezikshme, mbeturinat ujore, sedimentet, etj. • Rritje e rrjedhjeve dhe e rrezikut të përmytjeve • Përmytje si pasojë e bllokimit të drenazhimeve dhe strukturave drenazhuese, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Projektimi i kujdesshëm – ruajtja e drenazhimeve natyrore kur është e mundur, të konsiderohen shtrirje alternative • Ruajtja e kujdesshme e materialeve dhe mbeturinave të rrezikshme, sigurimi i drenazhimeve të përshtatshme për mbeturinat ujore dhe derdhje e kujdesshme e mbeturinave • Të zbutet shpejtësia dhe volumi i rrjedhjeve, të sigurohen struktura mbajtëse/ sedimentimi sipas nevojës 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Cilësia e Ajrit	<ul style="list-style-type: none"> Pluhuri gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, sipas sipërfaqes së rrugës Tymrat e trafikut gjatë fazës ndërtimore dhe rritje e mundshme mbas fazës ndërtimore 	<ul style="list-style-type: none"> Të kontrollohet pluhuri me ujë Të kontrollohen metodat e ndërtimit dhe impianti, afatet e punimeve Të kufizohet shpejtësia e automjeteve dhe kalimi i trafikut në zonat rezidenciale gjatë dhe mbas fazës ndërtimore Projektim i kujdesshëm, sidomos në pikat me rrezikshmëri 	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
Mjedisi Akustik	<ul style="list-style-type: none"> Zhurma nga punimet ndërtimore, trafiku – shpejtësia, sasia dhe lloji i trafikut gjatë dhe mbas fazës ndërtimore 	<ul style="list-style-type: none"> Të përcaktohen afate të punimeve për të minimizuar shqetësimet Të përdoren metoda dhe pajisje të përshtatshme ndërtimi Të kufizohet shpejtësia e automjeteve dhe kalimi i trafikut në zonat rezidenciale, sidomos e kamionëve, duke përdorur shenja dhe projektim të përshtatshëm 	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
<i>Mjedisi biologjik</i>				
Habitatet Natyrore	<ul style="list-style-type: none"> Shqetësimi ose humbja e habitateve natyrore dhe shqetësimi i zonave të mbrojtura gjatë dhe mbas fazës ndërtimore 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdesshme e kantierit, kryerje me kujdes e shtrirjes dhe projektimit të strukturave (sidomos për rrugët e reja), dhe/ose përcaktimi i kohës së punimeve (sezonale) Përzgjedhja me kujdes e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe metodave, Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Fauna dhe Flora	<ul style="list-style-type: none"> Humbja ose degradimi gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, sidomos për arsye të punimeve jashtë sezonit, ndryshimeve në regjimet mjedisore, p.sh ç'rregullimi i lëvizjeve të kafshëve të egra gjë që shkakton vrasje të tyre nga automjetet, etj. (shih edhe më sipër) 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdesshme e kantierit dhe projektim i kujdesshëm për të minimizuar efektet, sidomos për speciet e ndjeshme/të rralla Të merren në konsideratë shtrirje alternative dhe/ose vendosje të strukturave Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit Të punohet në mënyrë sezonale, sipas nevojës 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë projektimit/ Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
<i>Mjedi Social</i>				
Estetika dhe Terreni	<ul style="list-style-type: none"> Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje pemësh, bimësie, etj. Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe mbas fazës ndërtimore 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdesshme e kantierit dhe kryerje me kujdes e projektimit të punimeve, kontroll i objekteve të papërshtatshme Zëvendësim i pemëve të dëmtuara, strukturave të kufijve, etj. dhe ri-gjelbërim i zonave të punimeve Kryerje me kujdes e mbylljes dhe rregullimit të pikave të punimeve dhe hedhje e mbeturinave 	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë projektimit/ Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Shëndeti i Njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore Efekte mbi shëndetin nga mbeturinat e materialeve të rrezikshme të ndërtimit, aksidente këmbësorësh dhe automjetesh, Transporti i substancave të rrezikshme 	<ul style="list-style-type: none"> Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë. të përshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentet e kontratës. Të sigurohet informacion mbi masat zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nevojën për punime më siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, përfshirja e komunitetit, rrethimi i zonave të rrezikshme Hedhje e kujdesshme e mbeturinave Projektim i sakte, përfshi dhe masat e sigurisë në pikat e rrezikshme, rrethim, shenja rrugore, etj. Kufizimi i lëvizjes së materialeve të rrezikshme në zonat rezidenciale 	<ul style="list-style-type: none"> MPPTT Konsulenti Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë projektimit/ Për tu specifikuar në dokumentet e tenderit
Komunitetet e Njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimet sociale (rrugë të reja) 	<ul style="list-style-type: none"> Projektim i sakte për të minimizuar efektet sociale (për më në përgjithësi shih më sipër) 	<ul style="list-style-type: none"> Konsulenti 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë projektimit
Objektet Historike /Kulturore	<ul style="list-style-type: none"> Shqetësim/dëmtime/degradim i objekteve të njohura dhe të pazbuluara 	<ul style="list-style-type: none"> Vendosje/kryerje e kujdesshme e punimeve; masa të posaçme për zonat/burimet e njohura Të ndalohet puna menjëherë në afërsi të zbulimeve dhe të priten udhëzime nga autoritetet përkatëse 	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori i zbatimit të punimeve Bashkia 	<ul style="list-style-type: none"> Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Plani i Monitorimit Ambientalist

Faza	Aktiviteti Monitorues	Përgjegjësia	Zbatimi
Faza e Para-Punimeve/Vijës-Baze			
	<ul style="list-style-type: none"> Koordinim me Kontraktorët e tjerë për punimet ne infrastrukture ne te njëjtën zonë Siguria e mirëmbajtjes së shërbimeve ekzistuese (linjat telefonike, elektrike etj) 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia / Supervizori Bashkia / Supervizori 	<ul style="list-style-type: none"> Ne fillim te Fazës 2 Para përfundimit te Fazës 1
Faza e Punimeve			
	<ul style="list-style-type: none"> Probleme për popullatën lokale: zhurme, ajër i ndotur, pluhur Respektimi i PMA nga Kontraktorët: kontrolli i erozionit, mbrojtja e bimësisë, ndotja e terrenit dhe ujit. Zbatimi i masave te sigurisë nga Kontraktorët konform standardeve profesionale. Gjetja e alternativave për funksionimin normal te trafikut 	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori nen kontrollin e Bashkisë dhe te Supervizorit Bashkia Bashkia Policia rrugore 	<ul style="list-style-type: none"> Gjate mbikëqyrjeve periodike te punimeve Gjate mbikëqyrjeve periodike te punimeve Mujore Gjate zbatimit te punimeve.
Përfundimi/Faza Operative			
	<ul style="list-style-type: none"> Siguria Rrugore, trafiku Pastrimi përfundimtar i zonës 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Kontraktori i zbatimit të punimeve 	<ul style="list-style-type: none"> E përditshme pas vënies ne funksionim Pas vënies ne funksion

HARTOI
"ERALD-G" SH.P.K
ING.GEZIM ISLAMI